REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:273243
Datë: 26.05.2021
Numri i dokumentit: 01816384

A.nr.2627/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Arjeta Sadiku dhe me procesmbajtësen Nazmije Beka, në konfliktin administrativ të paditësit A.M, nga fshati .., Komuna e..., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, me bazë juridike: anulim i aktit administrativ, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në mungesë të palëve, me datën 18 maj 2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A.M, nga fshati ..., Komuna e ..., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)-Departamenti i Pensioneve i datës 12.10.2018.

A r s y e t i m i

Paditësi A.M, nga fshati ..., Komuna e ..., me padinë e datës 01.11.2018, ka kërkuar nga gjykata që të anulojë aktvendimin e të paditurës të datës 12.10.2018, me të cilin i është refuzuar si e pabazuar ankesa për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Paditësi pretendon se vendimi i të paditurës është i kundërligjshëm, ngase i njëjti i plotëson të gjitha kriteret që parasheh ligji për të qenë shfrytëzues i këtij pensioni. Ngase nga arsyetimi i vendimit të kontestuar është refuzuar ankesa pasi që nga vlerësimi i dokumentacionit mjekësorë dhe vlerësimit të komisionit mjekësorë të shkallës së parë ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit. Kjo fare nuk qëndron pasi që komisioni mjekësorë i shkallës së dytë as që e ka ftuar paditësin për shqyrtimin e as për ekzaminimin e drejtpërdrejtë edhe pse një gjë e tillë është kërkuar nga paditësi. Shton se paditësi nuk është i aftë të kryej asnjë punë të dobishme për familjen dhe rregullisht dikush

2019:273244

nga anëtarët e familjes duhet të kujdeset për të për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore. Gjithashtu thekson se gjendjen ekonomike e ka të vështirë dhe se asistenca sociale nuk mjafton për trajtimin e tij mjekësor. I propozon gjykatës që të aprovojë padinë si të bazuar, ndërsa vendimi i të paditurës të anulohet.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 18.02.2020 e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar. Ka theksuar se duke pasur parasysh se paditësi nuk i plotëson kushtet për njohjen e të drejtës në pension për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik, i propozon gjykatës që të refuzojë padinë e paditësit si të pabazuar duke lënë në fuqi vendimin e të paditurës.

Në seancën e datës 18 maj 2021, palët janë ftuar me rregull, në seancë nuk janë të pranishëm asnjëra palë, ftesës së gjykatës nuk iu kanë përgjigjur, mungesën nuk e kanë arsyetuar. Andaj, gjykata konform nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), seancën e ka mbajtur në mungesë të palëve.

Gjykata në seancën e datës 18 maj 2021 ka bërë administrimin e provave dhe atë: Raportet mjekësore datës 23.01.2018, 26.01.2018, 24.01.2018, 21.01.2018, 23.04.2018, 27.06.2018, Vendimet e datës 02.07.2018 dhe 12.10.2018, vlerësimi i komisionit mjekësor i datës 15.08.2018, si dhe rivlerësimi i datës 25.09.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është **e pabazuar**.

Me vendimin e organit të shkallës së parë është refuzuar kërkesa e paditësit për njohjen e të drejtës për kompensim për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Në procedurën sipas ankesës, organi i paditur i ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë, vlerësimin e komisionit të shkallës së parë, ka konstatuar se paditësi nuk ka dëshmi të mjaftueshme mjekësore për të qenë përzgjedhës i të drejtës për kompensim për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik, andaj e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar. Paditësi i pakënaqur me këtë aktvendim, ka ushtruar padi, duke kundërshtuar të njëjtin si të kundërligjshëm.

2019:273244

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e këtij akti, u bazua në Ligjin 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, i cili përcakton kriteret në bazë të të cilave një person fiton të drejtën për këtë kategori, gjithashtu në vlerësimin e komisionit mjekësor. Në bazë të vlerësimit të Komisionit Mjekësor, është vërtetuar se paditësi, nuk i plotëson kriteret për të qenë përfitues i këtij lloj pensioni siç përcaktohet me ligjin e lartcekur.

Prandaj, gjykata vlerëson se duke u bazuar në të lartcekurat, organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore në bazë të të cilave edhe është refuzuar kërkesa e paditësit, për njohjen e të drejtës në pension të personave me aftësi të kufizuar.

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe nga ana e organit të shkallës së parë dhe në kundërshtim me vlerësimin e Komisionit Mjekësor në kuadër të paditurës si dhe me provat në shkresat e lëndës. Paditësi nuk dëshmon pretendimet e tij, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj gjykata nuk i aprovoi pretendimet e paditësit sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.2627/18 me datë 18 maj 2021

Sekretarja Juridike **G j y q t a r j a**
Nazmije Beka **Arjeta Sadiku**

***KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*

2019:273244